




Në bazë të nenit 157 të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 104/2019, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/22, 236/22, 65/23 dhe 192/25), Komisioni për sigurimin e mjeteve për shërbime sociale nga komunat dhe ofruesit e tjerë, i formuar nga Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë publikon

KONKURS PUBLIK

për ndarjen e mjeteve për shoqatat dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale për ofrimin e shërbimeve sociale

1. Lloji i shërbimeve:

Me këtë Konkurs publik sigurohen mjete për shoqatat e qytetarëve dhe ofruesit privat të shërbimeve sociale për ofrimin e këtyre shërbimeve:



- a) Shërbimet në shtëpi
- asistencë personale dhe
- ndihmë dhe kujdes në shtëpi,

- b) Shërbimet e mbrojtjes jashtë-familjare
- jetesë me mbështetje,
- sistemim në institucion për trajtimin dhe rehabilitimin e personave me probleme të varësisë,

- c) Shërbimet në komunitet
- cëndrimi i përkohshëm
- Qendra për viktimat e dhunës në familje,
- Qendra për viktimat e dhunës me bazë gjinore,
- Qendra për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

- kujdesi ditor
- Qendra ditore për fëmijët në rrezik,
- Qendra ditore për personat me nevoja,
- Qendra ditore për personat me nevoja me punë individuale
- Qendra për rehabilitim dhe riintegrim
- Qendra për resocializim
- Qendra për qëndrim ditor të personave të moshuar
- Qendra për qëndrim ditor të personave të moshuar me plakje aktive
- Qendra për qëndrim ditor të personave të pastrehë

- ç) Shërbime për ndihmë dhe mbështetje profesionale

- d) Shërbime këshillimi
- Shërbime primare këshillimi
- Shërbime sekondare këshillimi
- Shërbime terciare këshillimi



2. Shuma e mjeteve për përfitues që ndahen dhe periudha kohore në të cilën do të kryhen punët

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të sigurojë mbështetje financiare për zbatimin e shërbimeve sociale në përputhje me kapacitetin e përcaktuar të ofruesve të licencuar të shërbimeve në aktvendimin për dhënien e lejes për kryerjen e punës në mbrojtje sociale dhe në përputhje me koston e shërbimeve për një shfrytëzues përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale në shtëpi, për mbrojtje sociale jashtë familjare, për mbështetje dhe ndihmë profesionale, për qëndrim ditor, për qëndrim të përkohshëm, për këshillim dhe zëvendësim të kujdesit familjar për vitin 2026, miratuar nga Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë nr. 02-8269/1 i dt.22.12.2025 i përpiluar në përputhje me Metodologjinë për formimin e çmimeve të shërbimeve varësisht nga normativat dhe standardet për ofrimin e shërbimit social (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 264/19). Për ofruesit e licencuar të shërbimeve sociale që kanë lidhur një kontrata administrative për vitin 2025 për ndihmën dhe kujdesin e shërbimit social në shtëpi, do të sigurohen mjete në vitin 2025 për të njëjtin numër kujdestarësh për të cilët ishin financuar më parë. Mjetet do të sigurohen për përfitues në baza mujore, për të cilët Qendra për Punë Sociale ka nxjerrë vendim, në periudhën prej 01.01.2026 deri më 31.12.2026, përkatësisht:

a) Shërbime në shtëpi

Asistencë personale

- 389 denarë në orë për përfitues.

Ndihmë dhe kujdes në shtëpi

- 409 denarë në orë për përfitues.

b) Shërbimet e mbrojtjes jashtë-familjare

- jetesë me mbështetje

- 44.780 denarë në bazë mujore për jetesë me mbështetje 24 orëshe për fëmijë pa prindër ose pa kujdes prindëror, respektivisht 1.468 denarë në ditë për përfitues
- 28.527 denarë në muaj për jetesë me mbështetje të përkohshme të organizuar të personave me aftësi të kufizuara, respektivisht 935 denarë në ditë për përfitues,
- 39.363 denarë në muaj për jetesë me mbështetje ditore 8 orë të personave me aftësi të kufizuara, respektivisht 1.291 denarë në ditë për përfitues,
- 50.199 denarë në muaj për mbështetje 24 orë të personave me aftësi të kufizuara, respektivisht 1.646 denarë në ditë për përfitues.

Trajtim dhe rehabilitim i personave me aftësi të kufizuara, personat që kanë probleme me varësitë dhe personat e tjerë të marginalizuar /komuniteti terapeutik

- 42.384 denarë në muaj për përfitues për shërbime 24 orë ose 1.390 denarë në ditë për përfitues.

c) Shërbime në komunitet

Qendra për qëndrim të përkohshëm

- 44.920 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në Qendër për qëndrim të përkohshëm të viktimave të dhunës në familje dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore, respektivisht 1.473 denarë në ditë për përfitues.
- 53.207 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në Qendrën për qëndrim të përkohshëm për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, respektivisht 1.744 denarë në ditë për përfitues.
- 45.413 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në Qendrën për qëndrim të përkohshëm për viktimat e dhunës me qenie njerëzore, respektivisht 1.489 denarë në ditë për përfitues, pa shpenzime rrjedhëse.

Qendra për qëndrim ditor, qendra për rehabilitim

- 20.938 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në Qendrën për qëndrim ditor për fëmijët në rrezik, për përfitues, respektivisht 952 denarë në ditë për përfitues



- 33.489 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në Qendrën për qëndrim ditor për personat me aftësi të kufizuara, për përfitues, respektivisht 1.522 denarë në ditë për përfitues
- 1.411 denarë për trajtim individual në Qendrën për qëndrim ditor për personat me aftësi të kufizuara.
- 16.996 denarë në muaj për përfitues të shërbimit ditor në Qendrën për rehabilitim dhe riintegrim dhe Qendrën për risocializim, respektivisht 773 denarë në ditë për përfitues.
 - 16.997 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në qendrën ditore për të moshuar, gjegjësisht 773 denarë në ditë për përfitues.
 - 10.092 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në qendrën ditore për të moshuarit me moshë aktive, respektivisht 459 në ditë për përfitues.
 - 18.714 denarë në muaj për përfitues të shërbimit në qendrën ditore për persona të pastrehë, përkatësisht 851 denarë në ditë për përdorues.

ç) Shërbime të mbështetjes dhe ndihmës profesionale

- 8.866 denarë në muaj për shërbimin mbështetje dhe ndihmë profesionale të familjeve perkujdesëse.

d) Shërbime këshillimi:

Shërbimet primare të këshillimit:

- 1.233 denarë për këshillim individual në orë për përfitues,
- 330 denarë për këshillim grupor në orë për përfitues.

Shërbimet sekondare të këshillimit:

- 2.355 denarë për këshillim individual në orë për përfitues,
- 512 denarë për këshillim grupor në orë për përfitues.

Shërbimet e këshillimit terciar

- 3.060 denarë për këshillim individual në orë për përfitues, për trajtim psiko-social të kryerësve të dhunës në familje,
- 824 denarë për këshillim grupor në orë për përfitues, trajtim psiko-social i kryerësve të dhunës në familje,
- 2.526 denarë për këshillim individual në orë për përfitues, për trajtim psiko-social të grave viktime të dhunës dhe dhunës në familje dhe lloje të tjera të këshillimeve të specializuara,
- 675 denarë për këshillim grupor në orë për përdorues për trajtim psiko-social të grave viktime të dhunës dhe dhunës në familje dhe lloje të tjera të këshillimeve të specializuara.

3. Dokumentet e nevojshme

Parashtruesi i dorëzon këto dokumente:

1. Fletëparaqitje për aplikim për sigurimin e mjeteve (format i rekomanduar është publikuar në ueb faqen e Ministrisë www.mtsp.gov.mk)
2. Çadrin e plotë dhe adresën e subjekteve me aktivitete të definuara qartë gjatë realizimit të programit për ofrimin e shërbimeve sociale për të cilin kërkon ndarjen e mjeteve,
3. Programi për punë me përshkrim detal të aktiviteteve dhe me plan konkret pune për implementim dhe periudha e realizimit të programit për ofrimin e shërbimeve sociale për vitin që financohet, me të cilat do të sigurohet realizimi i qëllimeve të parashikuara, aktiviteteve dhe shërbimeve të definuara në konkursin publik me mjetet e parashikuara;
4. Lista e të dhënave për kuadrin profesional dhe personave të angazhuar për ofrimin e shërbimit social;
5. Të dhëna kontakti për personin përgjegjës/koordinatorit për realizimin e Programit për ofrimin e shërbimit social (emri, mbiemri, e-mail adresa dhe numri i telefonit),
6. Të dhëna për përvojën e punës në fushën e mbrojtjes sociale, sipas kërkesave dhe nevojave të konkursit publik, partneritetit të arritur, bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkëfinancimit të ofruar (nëse ka),
7. Dëshmi për mekanizmin e vendosur për kontroll të cilësisë së shërbimit dhe sistem i ankesave të klientëve (formularë)



8. Raport vjetor për punën e shoqatës, për vitin paraprak, respektivisht për vitin 2025.
9. Vërtetim për tatimet e paguara lëshuar nga organet tatimore të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale jo më të vjetër se gjashtë muaj (origjinal ose kopje të noterizuar).
10. Deklaratë nga ofruesi i licencuar i shërbimeve sociale **të vëlosur te noteri** se nuk ka marrë mjete nga ndonjë organ tjetër shtetëror ose njësi të vetëqeverisjes lokale për aktivitetet e njëjta për ofrimin e shërbimit
11. Aktvendim për dhënien e lejes për kryerjen e punëve në mbrojtjen sociale dhe të gjitha ndryshimet shitesë të tij (**në origjinal ose në kopje të noterizuar**).

4. Afatet për zbatimin e procedurës

Konkursi zgjatë **pesë ditë pune** nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Shoqatat e interesuara të qytetarëve dhe ofruesit privatë të shërbimeve sociale fletëparaqitjet mund t'i dorëzojnë më së voni deri në orën 16 në ditën e fundit të konkursit, respektivisht deri në orën 9 ditën e ardhshme nëse dita e fundit e konkursit bie në ditë jo unë, përmes Arkivit të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në adresën rr Dame Gruev, nr. 14 Shkup, në zarf të mbyllur me shënim: "Për konkursin publik për sigurimin e mjeteve për shërbime sociale".

Fletëparaqitjet që do të dërgohen pas këtij afati dhe me dokumentacion jo të plotë nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për sigurimin e mjeteve në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve përgatitë mendim tek ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë
Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, pas marrjes së mendimit nga Komisioni për sigurimin e mjeteve, miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve.
Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të lidhë Kontrata administrative me të cilën përcaktohen të drejtat e ndërsjella dhe përgjegjësitë në realizimin e mjeteve të ndara, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për ndarjen e mjeteve.

Shoqatat ose ofruesit privatë të shërbimeve sociale që do të marrin mjete nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë kanë për obligim që në të gjitha materialet (të shtypura dhe elektronike), që do të prodhohen në kuadër të këtij shërbimi, në vend të dukshëm të vendosin:

Përkrahur nga:



Republika e Maqedonisë së Veriut
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE